





I nderuar aplikues,

Në rast se do të zgjidheni si pjesmarrës në finalen Kombëtare Barista Challenge by Lavazza që do të organizohet nga Marketing & Distribution në data 25-26 nëntor 2024, duhet të keni parasysh kushtet dhe rregullat si më poshtë.

Do të konkurroni me konkurrentë të tjerë në një sfidë për të përgatitur një pije me bazë kafeje të nxehtë ose të ftohtë, me recetën personale, por duke e mbajtur kafënë si përbërësin kryesor që mund të kontribuojë në shije dhe të jetë pjesë e shpjegimit të konceptit të recetës. Baza e ekspresit duhet të jetë një nga mishelat e kafesë Lavazza Food Service. Ju keni lirinë për të zgjedhur mishelën bazuar në karakteristikat e shijes dhe mënyrën se si ai përzihet me pjesën tjetër të përbërësve për të krijuar sinergji. Kafeja nuk duhet të jetë shija mbizotëruese, megjithëse duhet të jetë e pranishme dhe në ekuilibër me pjesën tjetër të përbërësve që përdoren.

Ju do të vlerësoheni bazuar në performancën tuaj në skenë, përdorimin profesional të përbërësve, teknikat e përgatitjes së ekspresit, kreativitetin tuaj të pijes me bazë kafenë, sinergjinë e shijes dhe konceptin që qëndron pas ideve tuaja.

Ju do të keni dhjetë minuta në skenë për të përgatitur tre pije identike për t'i shërbyer tre gjyqtarëve vlersues shijesh, ndërsa një gjyqtar teknik do të vlerësojë performancën tuaj në skenë, ku do të prezantoni dhe shpjegoni konceptin dhe pijen tuaj.

Fituesi do të jetë ai që grumbullon pikët më të larta si shumë e të gjitha fletëve të vlerësimit nga gjyqtarët e shijes dhe gjyqtari teknik.

Në faqet në vijim, do të gjeni më shumë detaje mbi rregullat dhe rregulloret. Ju lutemi t'i studioni mirë në përgatitje për konkursin.

Paçi fat!

A. Përbërësit

Konkurrentët mund të përdorin çdo lloj përbërësi tjetër për recetën e tyre, megjithatë asnjë markë nuk lejohet të jetë e dukshme gjatë performancës në skenë.

Konkurrentët mund të përdorin kontejnerë ose kavanoza të vegjël gjatë kohës së konkursit për të zëvendësuar paketimin original.

Konkurrentët duhet të përmendin të gjithë përbërësit tek gjyqtarët dhe të jenë në gjendje të japin çdo informacion të nevojshëm, pas performancës në skenë.

Konkurrentët gjithashtu duhet të jenë në gjendje të japin të njëjtin informacion në rast të përdorimit të ndonjë përbërësi të bërë vetë.

Alkooli lejohet të përdoret si përbërës, për sa kohë që nuk cenon asnjë rregull të prodhimit vendor dhe përdorimin e paligjshëm.

B. Juria Lavazza

Juria e vlerësimit do të përbëhet nga katër profesionistë të Lavazza me ekspertizë të madhe në industrinë e kafesë.

Juria do të ndahet në: tre gjyqtarë shijesh dhe një gjyqtar teknik.

Do të ketë gjithashtu një menaxher skene dhe një kohëmatës për të organizuar rotacionin e konkurrentëve dhe për të regjistruar kohën e skenës së konkurrentëve përfundimtarë.

C. Pajisje, vegla dhe furnizime

Pajisjet e mëposhtme do të jenë në dispozicion për përdorim në vend gjatë konkursit:

- 1 aparat për ekspres* 2 grup për zonën e praktikës
- 1 aparat për ekspres* 3 grup për fazën e sfidës
- deri në 3 mulli sipas kërkesës*
- 2 miksera për Freddo
- Shaker
- Pjatararëse
- Lavaman
- 2 karroca kamarieri për largimin e materialeve të vendosur në skenë dhe jashtë saj

*Modelet e makinerive dhe bluarjeve do të komunikohen përpara konkurimit.

Pajisjet e mëposhtme do të jenë në dispozicion, sipas kërkesës, gjatë kohës së praktikës:

- Tamper
- Produkte për pastrimin e makinerive dhe mullirit
- Enë qumështi
- Peshorja
- Filxhanë të markës Lavazza (Espresso, Kapuçino dhe gotë 12 oz)

Nga konkurrentët kërkohet që të sjellin çdo pajisje shtesë të nevojshme për prezantimin e tyre.

Lista e artikujve që konkurrentët mund të sjellin nëse e kanë të domosdoshme përfshin sa vijon:

- Tamper
- Gota shots
- Xhezve
- Gotat e servirjes dhe aksesoret shoqërues
- Çdo vegël specifike e nevojshme
- Peshqir bari/lecka të pastra (për praktikë dhe konkurs)
- Tabaka(t) (për servirjen e pijeve për gjyqtarët)

D. Koha e praktikimit

Salla e përgatitjes/praktikës do të ketë një makinë ekspres me 2 grupe dhe mulli identike me pajisjet e konkurrencës në skenë.

Çdo garues do të ketë një kohë të planifikuar të stërvitjes prej 10 minutash. Oraret e stërvitjes do të planifikohen në bazë të kohës së garës (p.sh., garuesit e parë të planifikuar do të kenë oraret më të hershme të planifikuara të stërvitjes).

Orari i garave do të formulohet nga një short që do të zhvillohet gjatë një "takimi të konkurrentëve" përpara fillimit të ngjarjes.

Gjatë kohës së praktikës, konkurrentët do të kenë mundësinë të kalibrojnë bluarësit e tyre me përzienjen e zgjedhur të kafesë nga portofoli i Lavazza dhe mund të përdorin të njëjtin mulli në skenë. Çdo përgatitje tjetër shtesë mund të bëhet përpara kohës së skenës në tavolinat e disponueshme që çdo konkurrent do të ketë akses para, gjatë dhe pas eventit.

E. Mbështetësit/Asistentët

Asnjë person(a) përveç konkurrentit dhe gjyqtarëve nuk mund të jenë në skenë gjatë kohës së përgatitjes dhe pastrimit të konkurruesit. Gjatë kohës së garës, askush nuk lejohet të jetë në skenë përveç garuesve dhe gjyqtarëve, përndryshe garuesi përballet me dënimin me përjashtim nga gjyqtari kryesor.

F. Koha e përgatitjes dhe paraqitja në skenë (banak)

Çdo garues do të ketë 10 minuta kohë përgatitore.

Pasi konkurrenti i mëparshëm të fillojë kohën e tij të garës, konkurrenti tjetër i planifikuar mund të fillojë kohën e tij 10-minutëshe të përgatitjes pas njoftimit nga menaxheri i skenës dhe/ose kohëmatësi i përgatitjes.

Qëllimi i kohës së përgatitjes është ngritja e stacionit dhe përgatitja e skenës suaj. Kur të mbarojë koha dhe konkurrenti i skenës të ketë përfunduar performancën e tij (dhe Banaku I konkurimit është pastruar), ju do të keni 10 minuta për të zhvendosur përbërësit tuaj në zonën e skenës (banaku I konkurimit), për ti organizuar dhe paraqitur ato për shfaqjen skenike gjatë performancës. Në këtë pikë mund të lëvizni edhe të përdorni mullirin që keni kalibruar gjatë përgatitjes me mbështetjen e një anëtari të organizuesit. Pas kësaj, do të keni 10 minuta kohë për konkurim.

Përmbledhje:

- 10 minuta në fazën e praktikës
- Zhvendosja për tek Banaku I konkurimit 10 minuta
- Koha e garës 10 minuta

G. Në skenë

Çdo konkurrent ka 10 minuta për të përgatitur, paraqitur dhe shërbyer 3 pije identike.

Numërimi i kohës do të fillojë me kërkesën e konkurrentit duke i thirrur "TIME" kohëmatësit.

Konkurrentët lejohen të përdorin muzikën e tyre si pjesë e shfaqjeve të tyre në skenë. Në raste të tilla, konkurrentët mund t'i ofrojnë ekipit organizator këngën e tyre të preferuar 10-minutëshe muzikore në .mp4 në një disk USB të paktën 24 orë përpara fillimit të ngjarjes. Kur përdorni muzikë, konkurrenti mund të kërkojë që kënga e tij të fillojë dhe më pas të thërrasë "Time" për të filluar numërimin e kohës së performancës.

H. Koha e Përfundimit të Konkursit

Koha e garës do të ndërpritet kur një konkurrent ngre dorën dhe thotë "TIME".

Është përgjegjësi e konkurrentit të thërrasë qartë "TIME" për të lejuar që koha të regjistrohet me saktësi.

Dënimet jashtë orarit

Për prezantimin e skenës, rezultatit përfundimtar do t'i hiqet 1 pikë për çdo sekondë vonesë.

M. Pastrim

Pasi një konkurrent të ketë mbaruar kohën e konkurrimit, ai duhet të fillojë pastrimin e banakut dhe zonës së konkurimit.

Nëse është përdorur një karrocë kamarieri, organizatori do të sigurojë kthimin e karrocës.

Konkurrentët pritët të heqin të gjitha pajisjet dhe furnizimet e tyre personale dhe të fshijnë tërësisht vëndin e konkurimit.

Gjyqtarët nuk e vlerësojnë prezantimin gjatë kohës së pastrimit.